



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.1068/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevci anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtarit Lgjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me apelin e Muhamet Avdyilit, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 13.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet pjesërisht si i bazuar apeli i Muhamet Avdyilit, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj në Vendvotimet: 2528D, 02D, 01R, 2533D/02D.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutit e Vendvotimeve si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

IV. Refuzohet si i pabazuar apeli në raport me vendvotimin nr. 2513D.

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një apel përmes dërgesës postare me datën 10.11.2017 e njejta e protokolluar me datën 13.11.2017, nga Muhamet Avdyli me të cilën pretendon se në komunën e Ferizajit në vendvotimin 2528D/02D, më janë përvetësuar disa vota nga personat përgjegjës. Më tutje ka theksuar se në fshatin Prelez, në Qendrën e Votimit QV nr. 2533D/02D më janë

tjetërsu disa vota që kanë të bëjnë me emrin e personit Rushiti nga personat përgjegjës, pra komisioner nga radhët e subjektit politik LVV.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet në apel janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, ka vlerësuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, siç rezultojn edhe nga shkresat e lëndës andaj, mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në vendvotimet e cekura më lartë dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Paneli me rastin e vendosjes si në pikën IV të dispozitivit të këtij vendimi, paneli konstatoi se Vendvotimi: 2513D, i njëjti është numëruar në QNR, pasi që janë vlerësuar se kanë ekzistuar parregullësit në vendvotim, andaj paneli nuk gjeti arsye që të njëjtin Vendvotim ta kthehen prap në rinumërim.

Andaj, PZAP-i, nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura si në pikën II të dispozitivit.

Prandaj, me qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr. 1068/2017 më datën 13.11.2017.

Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.